



# Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

## Të Rinjët e Verbër Kërkojnë Alfabetin e Brajlit në Shkolla

Gëzimi, një djalë ambicioz, u takua me Drejtorin e Shkollës Speciale për Persona të Verbër dhe me të Pamur të Dobësuar për të kërkuar makina shkrimi të Brajlit shtesë për të gjithë studentët. Ai ka vendosur të vazhdoj të jetë këmbëngulës derisa shkolla të pajiset me makina të mjaftueshme për të gjithë studentët.

“Unë nuk e kam në plan të ndalem derisa të arrijë këtë qëllim. Nuk më brengos fakti se sa takime do të më duhet të mbajë,” tha ai.

Gëzimi ishte në mesin e të rinjëve të verbër dhe me të pamur të dobësuar që morrën pjesë në një diskutim për të promovuar përdorimin e alfabetit të Brajlit. Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës mblodhi disa të rinjë në qendrën e tyre të re me 14 Shtator në Prishtinë, për t'i informuar ata rreth iniciativës së re dhe për të marrë sygjerime.

Të rinjët ishin të ngazëlyer që Komiteti do të bashkëpunojë me shkollën fillore si dhe me Ministrinë e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të prezantuar për herë të parë tabelat e Brajlit. Alfabeti i Brajlit përdorë kombinime të ndryshme të gjashtë pikave, ku secili kombinim paraqet një shkronjë të alfabetit. Ky alfabet iu mundëson personave të verbër të lexojnë duke përdorur ndjenjen e prekjës, në vend se të përdorin sytë. Nëpërmjet prezantimit të tabelave të Brajlit në shkolla, Komiteti i Grave të verbëra të Kosovës do të ndihmojë studentët e verbër dhe me të pamurit e dobësuar të mësojnë alfabetin e Brajlit, që të jenë të aftë për të lexuar. Për këtë arsye, makinat e shkrimit të alfabetit të Brajlit janë të rëndësishme për nxënësit. Ato planifikojnë që së pari të prezantojnë tabelat këtë vit në shkollat “Emin Duraku” dhe “Anton Z. Çajupi” në Prishtinë.

Komiteti i Grave të Verbëra gjithashtu planifikon të përfshijë të rinjët në aktivitetet për ngritjen e vetëdijes në mesin e drejtorëve, mësimeve dhe nxënësve nëpër shkolla lidhur me nevojat e tyre dhe rëndësinë e përdorimit të alfabetit të Brajlit.

“Kam nevojë që ju të jeni nxënës me nota të shkëlqyeshme në shkollë dhe të shërbeni si shembull pozitiv për nxënësit tjerë, në mënyrë që t'i bindim njerëzit të na ndihmojnë për të arritur qëllimin tonë,” tha

### Bashkangjituni!

Retreat i RrGGK (Vetëm anëtarët)  
3-6 Tetor, Durrës, Shqipëri

### Në këtë numër

RrGGK dhe AH Prezantojnë të  
Dhënat Fillestare të Hulumtimit:  
“Ku Janë Paratë për të Drejtat e  
Grave?” .....2

Vajzat në Prizren të Pasionuara pas  
Avokimit .....3

Vajzat në Gjiilan Kërkojnë Psikologë  
në Shkolla.....3

RrGGK Vlerëson Kelmendin dhe  
Gjakoven si Shembuj Pozitiv .....4

Adoleshentët Promovojnë Barazinë  
Giinore përmes Grafiteve .....4

 [Faqja në Facebook](#)

 [Lista e dërgesave të E-lajmeve](#)

Drejtoresha e Komitetit, Bajramshahe Jetullahu.

Iniciativa e Komitetit inkurajon të rinjët të avokojnë për të drejtat e tyre në edukim. “Nevoja jonë më e madhe është që të kemi mirëkuptimin e qytetarëve,” tha njëra nga vajzat pjesë e iniciativës. “Ata duhet ta kuptojnë që kurrë askush nuk mund ta dijë se çfarë do t'i sjellë jeta. Ndoshta një ditë edhe ata do të bëhen [të verbër] si ne, dhe do të kenë nevojë për dikë që t'iu ndihmojë.”

Iniciativa e Komitetit të Grave të Verbëra të Kosovës është përkrahur nga Fondi i Grave të Kosovës në RrGGK.



Të rinjët lexojnë alfabetin e gjuhës shqipe në tabelën e Brajlit të krijuar nga Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës.

## RrGGK dhe AH Prezantojnë të Dhënat Fillestare të Hulumtimit: “Ku Janë Paratë për të Drejtat e Grave?”

Me 2 Shtator, RrGGK dhe Alter Habitus – Instituti për Studime në Shoqëri dhe Kulturë (AH) prezentuan të dhënat fillestare të hulumtimit: “Ku janë Paratë për të Drejtat e Grave?”

Hulumtimi përfshinë një anketim të zhvilluar me mbi 90 organizata të grave dhe intervista me mbi 35 donatorë. Rekomandimet e nxjerra përqipen të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin në financimet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe organizimin për të drejtat e grave në Kosovë, duke përfshirë rekomandime për “shtetin, donatorët dhe organizatat e grave”. Rreth 90 pjesëmarrës morrën pjesë në takim, përfshirë anëtare të RrGGK, anëtare të bordit, donatorë dhe përkrasës të tjerë të RrGGK. “Ju keni bërë një punë të shkëlqyer për një periudhë kaq të shkurtë me fonde minimale”, tha Advije Gashi nga Shoqata e Avokatëve “Norma”.

Gjetjet fillestare të anketimit tregojnë një rënie të dukshme të fondeve që ofrohen për OJQ-të e grave në mes të viteve 2000 dhe 2013, me një rritje të vogël në vitin 2011. Të dhënat tjera kyçe përfshijnë:

- Me përjashtim të disa organizatave me bazë në Prishtinë, shumica e organizatave të grave kanë hasur në vështirësi për sigurimin e resurseve të mjaftueshme për çështjet e tyre, grupet e synuara dhe strategjitë.
- Vetëm një numër i vogël i organizatave të grave marrin të ardhura nga individët, asetet, pagesat e anëtarësisë ose nga aktivitetet që sjellin të hyra, që nënkupton varësi të madhe nga fondet ndërkombëtare dhe diversifikim të pamjaftueshëm burimesh.
- Resurset e pamjaftueshme kanë shtyrë shumicën e organizatave të reduktojnë stafin, të zvogëlojnë aktivitetet ose të punojnë në mënyrë vullnetare për periudha të gjata kohore. Më shumë se një e treta e organizatave të grave kanë qenë në rrezik që të mbyllin zyrat e tyre, ndërsa disa prej tyre i kanë mbyllur ato kohë pas kohe, shpesh me pasoja të rënda për grupet e marginalizuara, siç janë personat që kanë pësuar nga dhuna në bazë gjinore.
- Prej donatorëve që kanë marrë pjesë në hulumtim, vetëm pesë kishin financuar organizatat e grave. Disa prej tyre kanë ofruar fonde përmes aplikimeve të rregullta (p.sh., për grante ose kontrata), për të cilat organizatat e grave garojnë me organizata ose biznese të tjera. Donatorët janë të prirë të ofrojnë fonde afatshkurtra, të bazuar në projekte.
- Shumica e organizatave të grave nuk kanë marrë kurrë fonde institucionale.

Pas prezantimit, pjesëmarrësit ofruan komente lidhur me gjetjet fillestare dhe rekomandimet e hulumtimit. Gjithashtu, nëpërmjet ofrimit të gjetjeve fillestare, RrGGK dhe AH janë munduar të inkurajojnë organizatat e grave dhe donatorët të japin informacione shtesë, me qëllim që të ofrohet një pasqyrë më e kompletuar e fondeve që janë dhënë për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave gjatë viteve 2000 dhe 2010 në Kosovë. RrGGK dhe AH do t'i përfshijnë të gjitha informatat e tyre në raportin final, të cilin do ta prezantojnë publikisht në Nëntor.

“Mendoj që ky është një raport shumë i dobishëm i cili po publikohet në një moment strategjik” tha Lina Andeer, përfaqësuese e Kvinna till Kvinna. “Më bën të reflektoj për organizatën time. Ne momentalisht jemi në proces të planifikimit strategjik dhe unë definitivisht mund ta përdor këtë raport për diskutimet tona të brendshme. Ajo çka unë shpresoj që do të zhvillohet pas publikimit të këtij raporti është një diskutim i thellë mbi hapat që duhet të marrim sa i përket trendeve negative me të cilat po ballafaqohemi [...] të identifikojmë se si shoqëria civile dhe donatorët do të mund të bashkëpunojnë për të ndryshuar këtë trend negativ.”

Hulumtimi është përkrasur nga Association for Women’s Rights in Development (AWID), me kontribut substancial edhe të RrGGK dhe AH.



Ariana Qosaj-Mustafa, Kryetare e Bordit të RrGGK moderon prezantimin e të dhënave fillestare të hulumtimit të RrGGK dhe AH: “Ku Janë Paratë për të Drejtat e Grave?”

## Vajzat në Prizren të Pasionuara pas Avokimit

Stili dinamik i jetesës ndonjëherë e bën të vështirë për vajzat për tu takuar dhe për të diskutuar për çështje që ndikojnë dhe prekin të drejtat e tyre. [Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave \(IFV\)](#) u ka ofruar hapësirë vajzave nga Prizreni të mblidhen dhe të krijojnë strategji për adresimin e sfidave me të cilat ato përballen në komunën e tyre.

Gjatë takimit, ato zhvilluan një strategji të avokimit për të mbështetur të drejtat e grave në edukim dhe për të mbështetur reduktimin e diskriminimit të grave në punë. Në diskutimin e zhvilluar për gratë që punojnë, ato vërejtën që shumica e punëve që kryhen nga gratë nuk konsiderohet si punë, por më shumë si “përgjegjësi e grave.” Si të tilla, punët e shtëpisë, përkujdesja për fëmijët dhe përkujdesja për të moshuarit në familjet e tyre nuk sjellë ndonjë përfitim material.

“Ky takim na ndihmoi t’i shohim gjërat nga një perspektivë tjetër,” tha njëra nga pjesëmarrëset.

Më tutje, vajzat diskutuan edhe për çështje të tjera me të cilat ato ballafaqohen, përfshirë çasjen në edukim.

“Një çështje shumë shqetësuese, për shembull, është kur familja e një vajze i thotë asaj që ata [familja] kanë bërë çdo gjë që duhet dhe edukimi nuk është i nevojshëm për të,” tha njëra nga vajzat. “Në këtë mënyrë ata vendosin për vajzën e tyre pa i dhënë asaj mundësinë për të vendosur për të ardhmen e saj.”

Pas diskutimit mbi sfidat, vajzat u ndanë në grupe, për të krijuar një strategji e cila do të përdoret për të avokuar për ndryshime, brenda komunës së tyre.

“Ky takim është shumë interesant,” tha njëra nga vajzat. “Nuk kam pasur ndonjë përvojë të tillë më herët. “Në Prizren, ka shumë aktivitete që organizohen për të rinjtë, por jo të tilla që në mënyrë specifike fuqizojnë vajzat për të luftuar për të drejtat e tyre.”

Bëhuni pjesë e diskutimeve dhe iniciativave avokuese [në faqen e Facebook-ut të Inicativës](#) për Fuqizimin e Vajzave.

## Vajzat në Gjilan Kërkojnë Psikologë në Shkolla

Pas një takimi të suksesshëm me vajza ambicioze në Prizren, RrGGK u takua me vajzat në Gjilan. Ato e dinin saktësisht çfarë donin: psikologë në shkolla.

“Është shumë e rëndësishme që të kemi një psikologë në shkollë me të cilin/-ën do të mund të flisim lirshëm dhe të nxjerrim haptas problemet e adoleshencës me të cilat përballemi,” tha njëra nga vajzat.

“Ne nuk kemi kurajo që t’i ndajmë me prindërit tanë disa gjëra të cilat do t’i diskutonim me psikologun/-en, pasi që prindërit nuk kanë edhe aq durim që të na dëgjojnë,” shtoi një vajzë nga Ferizaji.



Vajzat diskutojnë strategjitë për të avokuar për praninë e psikologëve në shkolla.

Së bashku, vajzat planifikojnë të avokojnë për praninë e psikologëve nëpër shkolla përmes debateve me mësimdhënës, anëtarë të komunitetit, institucionet përgjegjëse dhe mediat. Ato poashtu duan të organizojnë fushata për ngritjen e vetësisë në mesin e prindërve lidhur me mënyrën e të folurit lirshëm me adoleshentët e tyre.

[Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave](#) “filloi në kohën e duhur,” tha një vajzë nga Gjilani. “Bashkëpunimi me njëra-tjetrën na bën të ndihemi më të forta në shtytjen përpara të kësaj çështje, si dhe çështjeve të tjera që do të bëjnë shoqërinë e Kosovës të kuptojë rëndësinë e barazisë gjinore.”

## RrGGK Vlerëson Kelmendin dhe Gjakoven si Shembuj Pozitiv

RrGGK iu dha çertifikata mirënjohjeje Majlinda Kelmendit dhe Nora Gjakovës, me 23 shtator, në Pejë. Të dy vajzat përfaqësuan Kosovën në Kampionatin Botërorë të Xhudos, ndërsa Majlinda Kelmendi solli medaljen e artë.

Anëtarët e RrGGK, në takimin e tyre të rregullt të mbajtur në muajin shtator vendosën që të shprehin mirënjohje për arritjet e vajzave, pasi që ato shërbejnë si shembull pozitiv për vajzat tjera në Kosovë.

Sic është shprehur edhe Majlinda Kelmendi në televizionin kombëtar, “Nuk është me rëndësi se ku fillon, por ku do të arrish. Me përkushtim, punë dhe vullnet të madh çdokush ia arrinë qëllimit që synon.”

Për më tepër, si kampione e botës në xhudo, Majlinda Kelmendi është heroina e parë kombëtare e Kosovës, si shtet i ri.


Anëtarët e RrGGK përgëzojnë Majlinda Kelmendin dhe Nora Gjakoven për arritjet e tyre dhe shpresojnë që do të arrijnë të fuqizojnë shumë vajza të tjera në Kosovë që të realizojnë ëndërrat e tyre.

Gjithashtu, RrGGK ka ftuar dy vajzat t'i bashkangjiten Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave.



*Një delegacion i RrGGK iu dha Çertifikata Mirënjohjeje dy kampioneve botërore të xhudos. Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova..*

## Adoleshentët Promovojnë Barazinë Gjinore përmes Grafiteve



Fushata “Bonu cool, mos bjer shpullë” ka organizuar edhe dy ngjarje të tjera gjatë muajit Shtator të vitit 2013. Njëra nga ngjarjet ishte konkursi me karakter garues i grafiteve, i cili u organizua për adoleshentët e moshave 13-19 vjeçare.

Tema e konkursit ishte “Barazia Gjinore/Dhuna te çiftet adoleshente”.

Artistë adoleshentë të grafiteve nga Prishtina, Peja dhe Gjiroka vizatuan grafitë në njërin nga rrugët e Prishtinës.

Vizatimi i muraleve/grafiteve është pjesë e fushatës së vetëdijësimit publik të implementuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), përmes projektit “Vetëdija Gjinore, Pjesë e Kulturës së Përgjithshme”, të mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Ngjarja tjetër e organizuar ishte promovimi publik i videospotit të këngës “Se vetëm zemra flet saktë”. Kjo video poashtu ngritë çështjen e vetëdijësimit gjinor duke folur kundër dhunës në baza gjinore tek adoleshentët. Kënga është komponuar dhe kënduar nga këngëtarja e mirënjohur kosovare, Rona Nishliu.

Kampanja “Bonu cool, mos bjer shpullë” synon të bëjë ndërgjegjësimin e të rinjve përmes përfshirjes së ndjeshmërisë gjinore në kulturën urbane.

Për më shumë informata, vizitoni uebfaqen e QKSGj-së: <http://kgscenter.net/>.

*Ky artikull është shkruar bazuar në informatat që QKSGj i ka ofruar RrGGK-së.*